



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 366 Prot.

Tiranë, më 13.032019

**VENDIM Nr. 30, datë 06.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, datë 06.03.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "MARIO" në përroin e Vilanit dhe Kranshës degë e lumit të Gostimës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan"* -subjekti "RONC ENERGIA ALBANIA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "MARIO" në përroin e Vilanit dhe Kranshës degë e lumit të Gostimës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan"* -subjekti "RONC ENERGIA ALBANIA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "RONC ENERGIA ALBANIA" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC "MARIO" në përroin e Vilanit dhe Kranshës degë e lumit të Gostimës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)